

**Bashkia:** KLOS

**Kryetar:** BASIR ÇUPA

**Fusha:** INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

**Premtime:**

1. Do të ndërhyet në infrastrukturën rrugore për të krijuar lidhje sa më optimale të çdo njësie, çdo fshati dhe lagjeje me qendrën e bashkisë
2. Do të ndërtohet ura e re në vendin ku është pasarela tek ish Pazari i Urës, gjë e cila do të mundësojë që njësia Xibërr të harmonizohet në distancë me njësitë e tjera në lidhje me qendrën e bashkisë, duke ndërtuar rrugën e re automobilistike që do të përshkojë itinerarin nga kjo urë, nëpër lagjen Ballosh të Fshatit drejt Qafë-Shkallesë e Xibrrit
3. Do të kryhet lidhja e fshatrave të Gurrës me Urën e Shulbatrrës dhe fshatrave të zonës së Kurdarisë me Suçin
4. Do të shtrohen me çakull mali të gjitha rrugët e fshatrave të Bashkisë së Re
5. Do të riparohet çdo ujësjellës ekzistues
6. Do të hartohet Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Klos
7. Do të kryhen riparime, shtrime dhe hapje akse rrugësh kudo që të janë e nevojshme
8. Do të kryhen ndërtime urash në ato vende ku nevojiten
9. Do të ndërtohet unaza e qytetit
10. Do të kryhet rikonstruksion dhe mirëmbajtje e ujësjellësit ekzistues në fshatin Cerrujë
11. Do të kryhet zgjerimi i qytetit në dy anët e lumit Mat
12. Do të kryet sistemimi i qendrës
13. Do të kryhet rikonstruksion i rrugës Klos-Xibër e cila e shkurton këtë rrugë nga 20 km në vetëm 7 km
14. Do të ndërtohet një treg, në qytetin Klos
15. Do të kryhet riparim i tubacionit të ujësjellësit të qytetit
16. Do të kryhet shtrim me çakull mali në lagjen Shënkoll
17. Do të hartohet projekti për furnizimin me ujë të pijshëm nga liqeni i Balgjajt deri tek fshatrat Pleshë dhe Cerrujë
18. Do të kryhet shtrim me çakull mali në lagjen Lika
19. Do të kryhet shtrim me çakull mali në lagjen Dalti
20. Do të kryhet zgjatimi i asfaltimit të rrugës deri në fshatin Cerrujë
21. Do të kryhet ndërtimi i ujësjellësit për Zallin e Pleshës deri te Muçajt
22. Do të asfaltohet rruga nga Qafë Shkalleja në qendër të Komunës Xibër
23. Do të kryhet ndërtimi i rrugës në lagjen Topalli 500 ml
24. Do të kryhet shtrim me çakull në rrugën e Dukajve
25. Do të kryhet sistemim dhe asfaltim i rrugës në lagjen Skënderaj
26. Do të ndërtohet një Xhami në fshatin Kurdari
27. Do të kryhet riparim i rrugës Kodra e Kadiut - Ura e Luses
28. Do të shtrohet rruga e varrezave L=120ml në fshatin Kurdari

29. Do të kryhet riparim i ujësjellësit dhe i rrjetit shpërnadarës në fshatin Kurdari
30. Do të vazhdohet asfaltimi i rrugës në fshatin Kurdari
31. Do të kryhet ndërtimi i rrugës Mastresh - Patin
32. Do të kryhet sistemim dhe asfaltim i rrugës xhamija e Bakut - shkolla 9 vjeçare
33. Do të kryhet rikonstruksion i ujësjellësit në fshatin Ripë
34. Do të kryhet lidhja e rrugës Rripe - Dom nga Zalli i Alliajve
35. Do të kryhet riparim rrugësh: Duka i vogël - L= 700ml; Duka i madh - L= 700ml; Koçaj - L=800ml; Aliajt-Shkolla 9 vjeçareL=800ml me kalldrëm

**Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT**

**Preftime:**

1. Do të jepen ndihma ekonomike për studentët që nuk përballojnë dot studimet
2. Do të përjashtohen nga taksat vendore mjetet e transportit të nxënësve
3. Do të miratohet një fond i veçantë, në vitin e parë të mandatit, për të gjithë nxënësit që vazhdojnë arsimin e mesëm të ulët e të lartë ( dy nivelet e arimit të mesëm, kl VI-XII) dhe që kanë distancën mbi 5 km nga banesa
4. Do të kryhet ngritja e ekipit të futbollit në Bashisë Klos
5. Do të kryhet rikonstruksion i veprave të trashgimisë kulturore
6. Do të ndërtohet një Pallat Kulture, në qytetin e Klosit
7. Do të kryhet ndërtim i çatisë së shkollës në fshatin Cerrujë
8. Do të ndërtohet një kalçeto në fshatin Kurdari

**Fusha: MJEDIS/TURIZËM**

**Preftime:**

1. Do të rikonstruktohen Kalaja Ilire dhe Kalaja e Pretrajkës si dy pika turistike me shumë vlerë dhe do të rikonstruktohen rrugët që të çojnë në këto bashki
2. Do të ndërtohet muzeu historik dhe etnologjik në territorin e bashkisë
3. Do të ndërtohet një objekt që do t'u përgjigjet kërkesave në rritje, të një qendre kulturore për zonën

**Fusha: BUJQËSI**

**Preftime:**

1. Do të ndërhyet në të gjitha kanalet vaditëse ekzistuese
2. Do të ngrihet Zyra e Bujqësisë dhe Veterinarisë të cilat do të japin konsulencë për fushat e ndryshme në të gjithë fshatrat e bashkisë së re
3. Do të bëhet pagesa e energjisë elektrike të pompave vaditëse për të gjitha pompat ekzistuese ose mirëmbajtjen e tyre, si dhe do të hartohen projektet e zbatimit për kanale të reja vaditëse
4. Do të bashkëpunohet me qeverinë dhe veçanërisht me hipotekën, në mënyrë që çdo fermer të marrë certifikatën e pronësisë për tokën që i takon

5. Do t'u japet përparësi politikave për nxitjen e sipërmarrjes në bujqësi e blegtori, duke stimuluar ngritjen e minifermave, komplekseve blegtorale, rritjen e shtimin e sipërfaqes së mbjellë me vreshta e pemë frutorë, por gjithashtu edhe ngritjen e punishteve agropërpunuese të perimeve e frutave
6. Do të rikonstruktohet tregu me parametra bashkëkohorë në qytet dhe mbi të gjitha do të sigurohet mirëadministrimi i tij
7. Do të kryhet rikonstruksion i kanalit vaditës nga Lusa deri në Darrasa
8. Do të kryhet mirëadministrimi i ujit vaditës nga rezervuari në fshatin Kurdari
9. Do të kryhet ndërtim i digës në Qaf Llapush për ujë vaditës dhe ujë të pijshëm
10. Do të kryhet riparim i pompës për fisin Boza
11. Do të kryhet pastrim i rezervuarit nga bordi i kullimit në fshatin Rripë
12. Do të kryhet rikonstruksion i kanalit vaditës në fshatin Rripë

**Fusha: TRANSPARENCA**

**Preftime:**

1. Do të ngrihet Zyra e Programimit dhe Zhvillimit me dy ose tre punonjës e cila do të hartojë prioritetet e Njesisë së Re duke mirëpërcaktuar funksionimin e saj si zyrë në konsultimin paraprak të çdo prioriteti me lagjen ku është projekti dhe çdo aktor të interesave në zonë, si mësues, mjekë, ekonomistë, fermerë, etj
2. Buxheti do të përgatitet në formën e draftit rreth 4 muaj më parë nga njësia përgjegjëse për hartimin e saj ku marrin pjesë të gjithë përgjegjësit e zyrave dhe më pas do të zhvillohen tre takime publike: një tek shkolla me mësuesit, një takim tek Qendra Shëndëtsore Klos me mjekët dhe një takim në bashki me të gjithë specialistët dhe përfaqësuesit e profesioneve të tjera të biznesit të madh e të vogël

**Fusha: SHËRBIMET SOCIALE**

**Preftime:**

**Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM**

**Preftime:**